



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:272787

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05454248

C.nr.4176/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtoresh profesionale K.R. në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses B.Lj. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Studio Ligjore & Financiare “Klinaku”, Prishtinë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, jashtë seancës gjyqësore, më datë **14.03.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses B.Lj. nga Prizreni, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me të cilën ka kërkuar që të “detyrohet e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të pagave të 13-ta, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, t’ia paguajë shumën prej 1,131.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% e cila llogaritet nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimit e përmbarimit të dhunshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja B.Lj. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare ”Klinaku”, Prishtinë, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, vlera e kontestit 1,131.00 euro.

Në padi, i autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura e sistemuar në punët dhe detyrat e punës për më tepër se 25 vjet përvojë të punës. Duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale më konkretisht nenin 17 par. 2, e paditura nuk ka bërë kompensimin e pagës së 13-të për vitet 2019, 2020 dhe 2021, në lartësi të pagës prej 377.00 euro. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin sipas dispozitave ligjore të lartcekur, i është drejtuar gjykatës me qëllim që të detyrohet e paditura, që paditëses t’ia kompensoj pagën e 13-të për vitet 2020, 2021 dhe 2022, në shumën e përgjithshme prej 1,131.00 euro. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura me datë 27.11.2023, ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Ka theksuar se e paditura, paditëses ia ka refuzuar kërkesën për kompensimin e pagave të 13-ta. Paditësja kërkesën e bazon në nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale, mirëpo një kërkesë e tillë është e pabazuar, pasi që nuk kanë mundësi buxhetore për një gjë të tillë, për shkak mjeteve të kufizuara buxhetore. Në këtë drejtim, me njoftimin nr. prot. 7954 të datës 27.10.2023, ka njoftuar gjykatën se që nga viti 2018 e deri në vitin 2022, nuk kanë pasur mundësi buxhetore që të përmbushin pagën e 13-të për të punësuarit e saj, në këtë rast as për paditësen. Andaj, ka propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Sh.S.K.U.K. - Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren dhe që e njëjta ka mbi 25 vjet përvojë pune tek e paditura, me pagë bazë prej 377.00 euro.

Kontestuese në mes palëve ishte nëse paditëses i takon e drejta për kompensimin e pagës së trembëdhjetë (13).

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021. Me nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, është paraparë se "punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit".

Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, përcaktohet në mënyrë shprehimore se çështja e kompensimit të pagës së trembëdhjetë (13), për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, respektivisht nëse ka mjete buxhetore. Pra, e drejta e punëmarrësit (paditëses) për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13), krijohet kur punëdhënësi (e paditura) nuk e përmbushë atë, ndërsa nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Në fund, është në barrën e punëdhënësit që të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e një kërkesë të tillë.

Së këndejmi, me njoftimin nr. prot. 7954 të datës 27.10.2023, e paditura në mënyrë konkrete dhe të detajuar ka ilustruar të dhënat se që nga viti 2018 e deri në vitin 2022, nuk ka pasur mundësi buxhetore për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13) për punëtorët (Paditësen).

Andaj, gjykata vlerëson se dispozita ligjore e nenit 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, nuk është e karakterit detyrues për palët kontraktuese. Kështu, duke u mbështetur edhe në mendimin juridik nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, duke qenë se të provuarit e faktit nëse ka mundësi buxhetore i ka takuar të paditurës, e njëjta me njoftimin nr. prot. 7954 të datës 27.10.2023, ka provuar se nuk ka mundësi buxhetore për të kompensuar pagën e trembëdhjetë (13) ndaj paditëses. Kësisoj,

gjykata duke vlerësuar bazën ligjore të theksuar më lartë dhe gjendjen faktike të vërtetuar, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses duhet refuzuar si e pabazuar. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia e paditëses, qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe në bazën juridike konkrete.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 par. 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*. Ndërsa në paragrafin 2 të nenit të lartcekur është paraparë se *“kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar Paditësja, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 450, 452 dhe 463 të LPK-së. Pra, përkundër faktit se pala paditëse i ka kërkuar shpenzimet procedurale, kërkesëpadia e saj ishte e pabazuar dhe kështu ka humbur kontestin në këtë procedurë gjyqësore. Në anën tjetër, përkundër faktit se e paditura ka fituar kontestin, e njëjta nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 të LPK-së lidhur me nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.4176/22 më datë 14.03.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.